

Projekti për Zhvillim të Turizmit "Mirësevini në Dukagjin" është i financuar nga BE-ja dhe menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë. Ky projekt zbatohet nga Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHWB) në bashkëpunim me Komunitet Gjakoë, Junik, Deçan, Pejë dhe Istog, dhe ka për qëllim që të kontribuoj në krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin e biznesit në turizëm duke mbështetur zhvillimin e mëtutjeshëm të resurseve njerëzore & përmirësimin e aseteve kulturore në regjionin Perëndim të Kosovës.

Prandaj, CHWB në bashkëpunim me Komunitet Gjakoë, Junik, Deçan, Pejë dhe Istog është në

kërkim të 20 ndërtesave tradicionale

(kullë, shtëpi qytetare, etj)

të cilat do të bëhen pjesë e rrjetit të **produktit turistik** në Komunitet përfituese

(Gjakovë, Junik, Deçan, Pejë dhe Istog)

Ndërtesat do të rinovohen pjesërisht në kuadër të projektit. Rinovimi përfshin rinovimin dhe adaptimin e shtëpisë për funksionim si produkt turistik (p.sh 'bujtinë'). Intervenimi në rinovim të shtëpive tradicionale mund të përfshijë (por nuk limitohet): (i)përmirësimin e hapësirave të fjetjes; (ii)rregullimin e hapësirave të higjienës; (iii)intervenime në dekoracionet karakteristike; (iv)ndërtimi i infrastrukturës ndihmëse; (v)rregullimi i qasjes në ndërtesë ose (vi)përforcimet e strukturës së ndërtesës;..etj. Projekti do të mbulojë koston e rinovimit deri në maksimum **10,000€** për ndërtesë. Kontributi i pronarëve në bashkë-financim të rinovimit është i mirëpritur dhe do të jetë kriter në seleksionim të objekteve.

Kushtet për aplikim:

1. Shtëpia duhet të jetë së paku 50 vjet e vjetër dhe të ketë së paku 100m² të shfrytëzueshme.
2. Shtëpia duhet të jetë brenda territorit të Komunitet përfituese Gjakoë, Junik, Deçan, Pejë dhe Istog.
3. Ofertuesit duhet të jenë pronarë legal të ndërtesës.
4. Përshkrimi i shkruar lidhur me idetë e pronarit/shfrytëzuesit për qëllimin e investimit. Ky përshkrim duhet të shpjegojë idetë se si ai/ajo do ta vë në funksion ndërtesën si produkt turistik (maksimum 300 fjalë).

Të gjitha këto kushte janë obligative!

Kriteret për vlerësim do të marrin parasysh:

- Gjendjen e ndërtesës (gjendja më e mirë konstruktive do të vlerësohet më shumë).
- Përshkrimi i funksionit (mënyra e qëndrueshme e gjenerimit të të hyrave dhe punësimit do të vlerësohet më shumë).
- Sigurimin e resurseve shtesë nga pronari ose donatorët (resurset mund të jenë fonde buxhetore ose fuqi punëtore).

Ftohen pronarët e *shtëpive tradicionale* me interes në zhvillim të produktit turistik 'bujtinave' nga Komunitet përfituese (Gjakovë, Junik, Deçan, Pejë dhe Istog) të tërheqin dhe dorëzojnë formularët e plotësuar [i.Formulari për Aplikim & ii.Formulari për përshkrim] në Zyrën e CHWB-së në Prishtinë (Qyteza Pejton, Rruga R. Zogoviq nr.8; Tel.: 038 243 918), ose në Pejë (Dede Gjo Luli nr.6; Tel.:039 421 325) ose në email adresën kosovo@chwb.org. Gjithashtu, te dy formularët mund të merren nga webfaqja <http://chwbkosovo.org/>. Afati fundit për dorëzimin e formularit është **06 Prill 2012**.



i.Formulari për Aplikim

- Ky dokument është formular aplikacion për përzgjedhje e shtëpive për renovim & shfrytëzimin e tyre si 'BUJTINA'

- Te dhënat e projektit: Projekti për Zhvillim të Turizmit "Miresevini ne Dukagjin" është i financuar nga BE-ja dhe menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian ne Kosove. Ky projekt zbatohet nga Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB) në bashkëpunim me Komunitat Gjakove, Junik, Deçan, Pejë dhe Istog

IDENTIFIKIMI I PRONARIT

Emri & Mbiemri:

Vendbanimi:

Nr I telefonit:

Numri I letërnjoftimit:

IDENTIFIKIMI I OBJEKTIT / ASPEKTI TEKNIK

Emri I Objektit:

Komuna / Fshati / Rruga:

Viti i ndërtimit:

A është objekti ne Listën e Monumenteve: PO JO

Numri I kateve:

Sipërfaqja e shfrytëzuar:

Sipërfaqja e parcelës:

Kulmi: I padëmtuar I dëmtuar

Konstruksioni meskatesh: I padëmtuar I dëmtuar

Muret e brendshme: I padëmtuar I dëmtuar

Fotot e katër fasadave te bashkangjitur: PO JO

Fotot e dhomave te bashkangjitura: PO JO

Objekte përcjellëse brenda parcelës: PO JO

- Nëse PO, cfare objektesh gjenden:

Numri kadastral:

Numri I fletës poseduese:

ASPEKTI SOCIAL

Numri I banoreve te objektit mbi 18 vjeç (< 18):

Numri I banoreve te objektit nder 18 vjeç (> 18):

A jeni I pajtimit qe te angazhoheni për krijimin e funksionimin e produktit turistik 'BUJTINAT': PO JO

NENSHKRIMI & DATA:

ii. Formulari për përshkrim (udhëzues për aplikuesit)

[Përshkrimi i shkruar lidhur me idetë pronarit/shfrytëzuesit për qëllimin e investimit. Ky përshkrim duhet të shpjegojë idetë se si ai/ajo do ta vë në funksion ndërtesën si produkt turistik]

- a) Ju lutem paraqitni me tekst mënyrën se si mendoni ta vëni në funksion ndërtesën pas renovimit! (maximum 150 fjale)

- b) Ju lutem e shpjegoni se si mund të menaxhohet ndërtesa juaj nëse ju vijnë vizitore / mysafir! (maximum 150 fjale)
